



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 - Nr. 16-12220/11
Kaçanik; 29.09.2011.

Në bazë të nenit 40.2.(b) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 30. të Ligjit nr.03/L-048 - Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 14 dhe 15. të Ligjit nr.04/L-001 të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011, të pikës 5. të Vendimit 01-Nr.05-5316/10. të datës 24.09.2009 – Për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2011 dhe vlerësimet për vitet 2012-2013., të nenit 34.5 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, me Rekomandim të KPF-a të datës: 22.09.2011 për rialokimi të shumave të ndarjeve buxhetore të vitit 2011 të propozuara nga Kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 29.09.2011, mori këtë:

V E N D I M PËR RIALOKIM TË MJETEVE NGA NDARJET BUXHETORE 2011 NË KATEGORINË E PROJEKTEVE KAPITALE

I

Me këtë vendim lejohet rialokimi i shumave të ndarjeve buxhetore të vitit 2011, në kategorinë e projekteve kapitale brenda programit buxhetor të Zyrës së Kryetarit në shumë prej **28.148,51 €**, dhe atë nga Fondi burimor - 10 në shumë prej 17.774,95 € dhe nga Fondi burimor – 22, shuma prej 10.373,56 €.

II

Rialokimi i ndarjeve buxhetore me lëvizjen e mjeteve të mbetura nga një projekt në projekt tjetër kapital brenda Organizatës buxhetore të komunës dhe të njejtit program buxhetor sipas pikës I. të këtij vendimi, do të mundësojë shtimin e efikasitetit në dinamikën e realizimit të projekteve kapitale dhe një përmbyllje të suksesshme në operimin me mjetet buxhetore për këtë vit vijues fiskal.

III.

Ndarjet buxhetore nga ky rialokim i mjeteve do të harmonizohen dhe përshtaten plotësisht ashtu siç janë pasqyruar në tabelarët e bashkangjitur – Tabela 3.1. dhe 4.1 dhe me Planin e rrjedhës së parasë, i cili pas aprovimit do t'i dorëzohet MF – Departamentit të Thesarit.

IV

Obligohet Drejtoria e Ekonomisë , Financave dhe Zhvillimit që me departamentet kompetente të MF-së, t'i ofroi të gjitha dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi.

V

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvend të Komunës dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit,
z. Xhelal Gashi
